



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:002419
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06762822

C-IV-14-2008

Ankuesi

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A, Prishtinë.

Kundër

E paditura

NSH “Auto Moto Kosova”, Prishtinë, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 24 janar 2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN073-0164, i datës 19 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 mars 2014, ankuesi Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (tutje PTK) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN073-0164, i datës 19 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar pagesën e faturave të papaguara, për NSH “Energomontimi” (në likuidim), në shumë prej 10,224,87 € për periudhën kohore shkurt – maj 2006.

Ankuesi pohoi se e konteston vendimin e AL-së si të pa bazuar nga se është i nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Po ashtu, ankuesi pohoi se është i pa qëndrueshëm konstatimi i AL-së se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ngase rasti konkret nuk është i përfshirë me parashkrim po ashtu, ankuesi pohoi se është e çuditshme se si

AL thirret në parashkrim dhe për këtë nuk e jep asnjë arsye dhe cila faturë është e parashkruar, ngase këtu nuk kemi të bëjmë me procedurë të rregullt gjyqësore në të cilën procedurë vlejné dispozitat tjera. Më tej ankuesi pohoi se kërkesa është e bazuar dhe e mbështetur me prova materiale dhe se këtë e dëshmojnë edhe hulumtimet nga Departamenti për Arkëtimin e Borxheve i PTK.

Me 13 maj 2019, gjykata kërkon nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Me 23 maj 2019 nëntor 2014, ankuesi ka kryer pagesën e taksës gjyqësore.

Me 26 dhjetor 2024, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa ka të bëjë me faturat e papaguara për periudhën shkurt – maj 2006 dhe se nuk ka asnjë provë para AL që ankuesi ka paraqitur këtë kërkesë në ndonjë gjykatë apo para ndonjë autoriteti tjetër kompetent. Sipas të paditurës, mbështetur në nenin 36.2.1 të Ligjit nr. 04/L-034 dhe nenit 378 të Ligjit mbi Kontratat dhe Detyrimet, parashikon që kërkesat për shpenzime postare dhe telefonike parashkruhen për tre vjet , në kuptim të këtyre dispozitave kërkesa duhet të jetë paraqitur para gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent brenda 1 viti nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë kryer ndaj parashtruesit detyrimet e saj që rrjedhin nga mardhënja tregtare. Mbrojtjes i ka bashkangjitur një kopje të vendimit të kundërshtuar nr. PRN073-0164 të dt. 19.03.2014

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Në bazë të nenit 374 të Ligjit mbi Detyrimet, (botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr. 29/1978, ligj i zbatueshëm në kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, tutje LMD i vjetër), parashihet se “Kërkesat e ndërsjella të personave juridik nga kontrata për tregtinë e mallrave dhe pretendimet për kompensimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me këto kontrata vjetërsohen për tre vjet”. Të njëjtin rregullim e parasheh edhe dispozita e nenit 355 të Ligjit mbi Marrëdhëniet

e Detyrimeve, (Ligji Nr. 04/L-077, ligj i zbatueshëm në kohën e marrjes së këtij vendimi. (tutje LMD në fuqi).

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të shërbimeve të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me shërbimet e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës, ankuesi kërkesën e ka parashtruar lidhur me pagesën faturave të papaguara, për periudhën shkurt – maj 2006 , në shumë prej 10,224.87 €. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për faturat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 29 janar 2014, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagesën e shërbimeve të pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala